



---

**RREGULLORE NR. 2004/42**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE  
I MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kapitullin 8 dhe nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke e marrë parasysh shkresën zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 30 qershor 2004 lidhur me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve i miratuar më parë nga Kuvendi i Kosovës më 16 qershor 2004,

Duke theksuar se dispozitat e Ligjit nuk e çenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo të kompetencave dhe përgjegjësiive të rezervuara të tij sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall të vlefshëm në ditën e nënshkrimit Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve i miratuar nga Kuvendi i Kosovës që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2004/17), me kusht që në nenin 18.2 fjalët “aktet nënligjore” të zëvendësohen me “aktet ligjore plotësuese”, në nenin 32.1, fjala “kombëtar” zëvendësohet me fjalën “Kosovës”, titulli i nenit 39 “Dispozitat ndëshkuese” zëvendësohet me “Sanksionet administrative”, në nenin 44, fjala “rregulloret” zëvendësohet me fjalët “rregullat dhe standardet”, fjala “dënimet” zëvendësohet me “gjobat” kudo që është përdorë në Ligj.

Nënshkruar sot, më 19 tetor 2004.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm